



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**V E N D I M**

**NR. 9/8 DATË 04 / 02 / 2021**

**PËR**  
**MIRATIMIN E STATUSIT “PROJEKT ME POTENCIAL STRATEGJIK**  
**JONIAN HEAVEN”, ME SUBJEKT PROPOZUES JONIAN HEAVEN GROUP SHPK**  
**NUIS/NIPT L91404041V**

Në mbështetje të Nenit 9, 14 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1024, datë 16.12.2015 “Për Miratimin e Projekteve me Statusin “Projekt me Potencial Strategjik”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë,

**VLERËSOI:**

- Projekti i paraqitur është në përputhje me parashikimet e legjislacionit të investimeve strategjike, për përfitimin e statusit “projekt me potencial strategjik”.
- Vlera e investimit të projektit me potencial strategjik “Jonian Heaven” plotëson kriteret e parashikuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe parashikohet të jetë 78,365,967 Euro.
- Hartimi i projektit dhe masterplanit është realizuar nga studio arkitekturore ndërkombëtare.
- Projekti propozohet nga subjekti "Jonian Heaven Group" shpk me NIPT L91404041V.
- Projekti “Jonian Heaven” synon të realizojë një kompleks turistik me 636 ambiente akomodimi, struktura akomoduese turistike si dhe ambiente shërbimi. Projekti i propozuar prek një sipërfaqe trualli në parcelat nr. 1936/5, 1936/6, 1936/7, në ZK. 3831, Vrinë, Bashkia Konispol dhe synon hapjen e 819 vende pune.
- Projekti synohet të realizohet në një zonë me bashkëpronësi ende të papjesëtuar mes shtetit dhe privatit.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

**KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**  
**VENDOSI:**

1. Miratimin e Statusit “Projekt me Potencial Strategjik” për projektin e investimit “Jonian Heaven” propozuar nga "Jonian Heaven Group" sh.p.k.
2. Projekti parashikon realizimin e një kompleksi turistik, hapjen e vendeve të reja të punës, nxitjen e zhvillimit ekonomik të zonës së Vrinës, specifikisht zona e quajtur ShënKoll i Detit, në Bashkinë Konispol, e cila ka një sipërfaqe totale prej 128 ha.
3. Statusi “Projekt me potencial strategjik” i jepet projektit të investimit “Jonian Heaven”, propozuar nga subjekti "Jonian Heaven Group" sh.p.k., për një periudhë 1 (një) vjeçare. Brenda kësaj periudhe, subjekti "Jonian Heaven Group" sh.p.k. duhet të aplikojë për përfitimin e statusit përfundimtar ‘Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë’, në përputhje me parashikimet e VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 dhe VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015.
4. Në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike, mbështetja që i aprovohet projektit me potencial strategjik, e cila detajohet sipas planit të veprimit që miraton ky vendim, është:
  - a) Asistencë në lidhje me mbledhjen e informacionit me të dhënat e karakterit teknik, ligjor dhe administrativ, të nevojshme për hartimin, përgatitjen dhe zbatimin e projektit të investimit.
  - b) Ofrim të shërbimeve të nevojshme ndaj projektit me potencial strategjik, përfshirë shërbime analize, vlerësimi, koordinimi informacioni, të konsolidimit të tokës, veprime të nevojshme lidhur me asistencën për pjesëtimin e pasurisë si dhe shërbime përfaqësimi tek autoritetet publike;
  - c) Asistencë e mëtejshme për përfitimin e statusit përfundimtar ‘Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë’;
5. Në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit me potencial strategjik “Jonian Heaven” konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e statusit projekt me potencial strategjik të këtij projekti, Komiteti i Investimeve Strategjike, ka të drejtë të revokojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.
6. Ky vendim i njoftohet investitorit si dhe publikohet në regjistrin e investimeve strategjike.

7. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Kulturës, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Agjencia e Trajtimit të Pronës, Bashkia Konispol dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

## **PLANI I VEPRIMIT PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT ME POTENCIAL STRATEGJIK JONIAN HEAVEN**

### ***Përmbajtja e planit të veprimit***

Plani i veprimit për realizimin e një projekti me potencial strategjik, përcakton:

- Procedurat lehtësuese që do të zbatohen për realizimin e investimit strategjik dhe afatet e përshpejtuara brenda të cilave duhet të kryhen;
- Shërbimet ndihmëse që do të ofrohen ndaj projektit strategjik;
- Masat mbështetëse që do të nevojiten për mbështetjen e investimit strategjik;
- Organet përgjegjëse për zbatimin e investimit strategjik;
- Detyrat përkatëse për secilin organ të përfshirë në realizimin e investimit strategjik;
- Programin e punës për realizimin e investimit strategjik të detajuar në faza;

### **Zbatimi i planit të veprimit**

Plani i veprimit ndiqet dhe zbatohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, e cila koordinon veprimtarinë me organet e tjera shtetërore dhe me investitorin.

Autoritetet publike, të përfshira në mënyrë direkte apo indirekte në realizimin e një investimi strategjik, kanë detyrimin ligjor në lidhje me trajtimin me prioritet të procedurave dhe brenda afateve të përshpejtuara. Këto organe kanë detyrimin ligjor që të bashkëpunojnë dhe t'i japin Agjencisë, sqarime, informacione, lejet, licencat, autorizimet, mendimet dhe dokumentet e nevojshme në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe realizimin e një projekti investues strategjik.

#### ***1. Informacione të përgjithshme mbi Planin e Veprimit të projektit Jonian Heaven***

Ky plan veprimi për realizimin e Projektit të Investimit “Jonian Heaven”, projekt me potencial strategjik, përcakton masat, procedurat dhe afatet, në lidhje me shërbimet dhe lehtësimin e procedurave për hartimin dhe zbatimin e projektit investues strategjik, në të cilin përcaktohen angazhime, detyra dhe afate konkrete për institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për të gjitha fazat e realizimit dhe zbatimit të projektit.

Plani i veprimit u hartua pasi propozimi i paraqitur mbi investimin strategjik të Projektit Jonian Heaven është vlerësuar paraprakisht dhe ka një rekomandim pozitiv për Komitetin e Investimeve Strategjike në lidhje me miratimin e tij. Autoriteti përgjegjës për miratimin e

planit të veprimit për çdo projekt strategjik të miratuar është Komiteti i Investimeve Strategjike.

## 2. Hapat procedurale

Masat mbështetëse të kërkuara janë si më poshtë vijon:

<b>Masat e kërkuara</b>	<b>Rekomandim</b>	<b>Institucioni përgjegjës</b>	<b>Procedura për masën e kërkuar e detajuar ne faza.  Detyrimet sipas institucioneve përgjegjëse</b>	<b>Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të përgatitet</b>	<b>Afati</b>	<b>Kosto</b>
Përcaktimi i procedurave për përgatitjen dhe zbatimin e këtij projekti investimi dhe masave mbështetëse që kërkohen.	PO	<b>MFE</b> <b>MBZHR</b> <b>MTM</b> <b>MIE</b> <b>MK</b> <b>AKZM</b> <b>AKPT</b> <b>AZHT</b> <b>ASHK</b> <b>BASHKIA</b> <b>KONISPOL</b> <b>AIDA</b>	Anëtarët e Grupit Operacional si dhe institucionet e listuara në këtë vendim duhet të angazhohen për të asistuar subjektin në qartësimin e procedurës që subjekti duhet të ndjekë në përgatitjen e dokumentacionit përkatës për përfitimin e statusit strategjik, procedurë e veçantë.	Lista e dokumenteve të përcaktuara nga legjislati investimeve strategjike për përfitimin e statusit “investim/investitor strategjik procedurë e veçantë” si dhe lista me dokumentacion që duhet të përgatitet në zbatim të legjislati në fuqi për trashëgimitë kulturore, zonat e mbrojtura, zhvillimin e territorit.		
Kryerjen e veprimeve të nevojshme për pjesëtimin e pasurisë ndërmjet shtetit dhe palës privat	PO	<b>ASHK</b> <b>ATP</b>	Në zbatim të Ligjit 111/2020, “Për kadastrën” ASHK është e ngarkuar për regjistrim fillestar të pasurive sipas vendimeve të Komisioneve të Kthimit të Pronave.	Dokumentacion ligjor sipas të cilit pretendohen pasuritë.		

			Procedura të bazohet në legjislacionin në fuqi.		
<p>Procedura për rishikim të kategorizimit të zonës së mbrojtur sipas gjurmës së projektit.</p> <p>Rishikim PPV Bashkia Konispol.</p> <p>Hartim PDZRK.</p>	PO	<p><b>MTM</b></p> <p><b>AKZM</b></p> <p><b>AKPT</b></p> <p><b>Bashkia</b></p> <p><b>Konispol</b></p>		<p>Kërkesë drejtuar AKZM për rishikim të kategorizimit të zonës së mbrojtur.</p> <p>Kjo kërkesë do duhet të vijojë me nevojën për rishikim të PPV Bashkia Konispol.</p> <p>Hartimi i PDZRK në rast se nga ndryshimi i PPV, njësitë strukturore XA.N.426 dhe XA.N.297, do të klasifikohen si njësi ku duhet të hartohet plan i detajuar.</p>	
<p>Identifikimi i procedurës me Ministrinë e Kulturës për paraqitjen e projekt propozimit për vlerësim e rekomandim tek Komiteti i Trashëgimisë Botërore.</p>				<p>Subjekti duhet të realizojë vlerësim trashëgimie kulturore ku të përfshihet vlerësim arkeologjik, mjedisor dhe impakt social ekonomik.</p>	

**KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**